



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 08 qershor 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Nim Huruglica dhe Valdete Krasniqi-Dogana e Kosovës, Dino Asanaj, Avni Jashari dhe Shkëlzen Lluca- AKP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.05.2011 dhe 25.05.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2010,
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.05.2011 dhe 25.05.2011

Muhamet Mustafa - Kërkoj që në procesverbalin e datës 25 maj 2011, fjalia “nuk është e rëndësishme pasuria?” të zëvendësohet me fjalinë “ çështje shumë relevante është mënyra e evidencimit të pasurisë”.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.05.2011 dhe 25.05.2011, me vërejtjen e deputetit Muhamet Mustafa.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2010

Kryesuesi - Pasqyrat financiare të hartuara nga ZAP-i përgjithësisht janë vlerësuar pozitivisht, Nga rekomandimet e vitit 2009 dy rekomandime kanë mbetur të pa shqyrtuara. Pyeti: në çfarë faze janë? Po ashtu kërkoj sqarim për garancionin bankar 100.000 euro dhe rreth asaj që quhet “duda”.

Naim Huruglica – JTe rekomandimet e vitit të kaluar të cilat kanë mbetur pa u përmbushur – janë ndërmarrë veprimet e caktuara për përmirësim, por nuk janë përmbushur 100%. Vërejtjet e auditorit kanë qenë që është dashur të jepen sqarime shtesë se pse është ndryshuar baza doganore, pse është shkruar në rritje të bazës doganore. Numri i lëndëve të cilat është bërë ndryshimi i bazës ka qenë një zvogëlim bukur i madh në krahasim me vitin 2009. Vërejtja e dytë ka qenë se subjektet të cilat shfrytëzojnë procedurat me ndikim ekonomik nuk raportojnë me kohë edhe kjo është një fakt të cilin me vendimin që e ka sjellë Kuvendi para një muaji kur ka aprovuar sistemin e ri elektronik “atituda” që quhet për doganë do t’i minimizoj në tërësi këto dy probleme. Ka vonesa në inkasim, por jo humbje. Në vitin 2010 kanë hyrë për afërsisht 450 milionë euro dhe humbjet thuajse janë zero. Me sistemin e ri elektronik “atitudat” dogana do jetë në gjendje që në mënyrë elektronike t’i përcjelli stoqet dhe në momentin kur dikush tenton t’i tejkalojnë shumën e stoqeve që i ka të mbuluar me garancion bankar atyre do t’i stopohet automatikisht e drejta e importit. Sistemi aktual nuk mundëson një gjë të tillë. Janë rreth 60 subjekte prodhuese të cilat i shfrytëzojnë depot doganore për import të lëndës së parë dhe për kompletimin e produktit final për të eksportuar, 70-75% të eksporteve aktuale në Kosovë janë duke ju falënderuar këtyre procedurave që po mundëson ligji. Konfiskohen shume mallra dhe me kalimin e kohës konfiskimi po bëhet më tepër i atyre mallrave të cilat as nuk janë përfshi për ruajtjen e mëtutjeshme. Zakonisht është fjala për mallra të cilat ose për shkak të Ligjit të pronësisë intelektuale ose për shkak të kufizimeve në shëndet nuk lejohen të dalin në qarkullim dhe Dogana ka provuar me kapacitetet e veta të krijoj depo me hapësira të mjaftueshme për ruajtjen e tyre, por jo gjithmonë ka pasur sukses. Tani është formuar edhe Agjencioni për ruajtjen e pasurisë së sekuestruar dhe Dogana është në bashkëpunim të ngushtë me ta që gradualisht me kalimin e kohës praktikant e mira të barten te ky agjencion.

Valdete Krasniqi – Lidhur me garancionin bankar, tha se do të dërgojnë një informatë më të detajuar (me shkrim) rreth kësaj çështjeje.

Muhamet Mustafa – Kishte mendim pozitiv për të arriturat e Doganës. Në raportin e ZAP-it evidentimi i deklarave të importit DUDA-ve doganore nuk është si duhet dhe nuk është sa duhet transparent. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Mursel Haljilji - Lidhur me mallin e konfiskuar pyeti cila është vlera e atij malli të konfiskuar i cili është shitur, dhe cila është vlera e mallit të dëmtuar, respektivisht vlera e mallit i cili është dëmtuar për shkak të kushteve joadekuate të ruajtjes nëpër depot doganore? Meqenëse Dogana nuk ka pasur kapacitete, pse nuk e ka filluar aksionin për ta ruajtur atë mall edhe nëpër depot private përmes marrëveshjeve për magazinimin (ruajtjen) e cila është një lloj i marrëveshjes ligjore?

Ramiz Lladrovci – Pyeti: pse është bërë pranimi i mallit dhe faturës, ndërsa më vonë është bërë kërkesa për blerje? Struktura organizative nuk është në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Drejtori i financave i raporton një nivelit më të ulët, nuk i raporton një nivelit më të lartë. Pse bëhet kjo?

Armend Zemaj - Tha se aty ku është futur apo tenton të futet politizimi i agjensioneve të pavarura me të vërtet ka edhe raporte të këqija. Në vitin e kaluar është ndryshuar Ligji për TVSH-në aneksin A që ka të bëjë me akcizat. Sa është implementuar kjo nga ana e Doganës përmes Udhëzimit Administrativ? Edhe pse nuk ka ndonjë sqarim nga auditori i jashtëm se a ka ndonjë rast të kalkulimit të akcizes në një rast të caktuar. A është bërë në përputhje me rregullat bazike apo jo? Në raport thuhet “*Vetëm thuhet të siguroj se në të gjitha rastet vlera e akcizes dhe doganës janë kalkuluar mirë dhe në përputhje me rregullat bazike*”. Pse akoma zyrtari certifikues, zyrtari kryesor financiar nuk funksionojnë sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësie.

Naim Huruglica – Tha se dogana nuk ndryshon bazën doganore, por ka kaluar në atë nivel sa që është arrit besueshmëria në dokumentacionin e prezantuar. Dhe 25% të dokumentacionit i cili rivlerësohet në realitet sjellin vetëm 4% të të hyrave të gjithmbarshme. Çka tregon se në masën 96% të të hyrave që sot grumbullohen, janë deklarime vullnetare. Asnjë rritje e bazës doganore nuk bëhet pa njoftimin e palës. Pala ka të drejtë të ushtroj ankesë dhe Dogana pranon rreth 200 ankesa në muaj, të cilat thuajse në masën 90% janë ankesa rreth rivlerësimeve. Fakti që gjithçka është e ruajtur në mënyrë elektronike sepse diku në masën 95% të deklarimeve bëhen elektronike, kjo e rritë në masë të madhe transparencën. Në ndërkohë janë krijuar edhe departamente të reja shumë më profesionale të cilat nga qendra japin kujdes që oficeri në kufi mos të vepron në mënyrë autoritative.

Malli i konfiskuar - Vlera gjithmonë lëvizë. Zakonisht, ose kohëve të fundit është sjell gati rreth 2 milion euro në depo. Vlerën e ka rritur vlera e mallrave të konfiskuara për të cilat nuk është gjetur mënyrë se si të shkatërrohen. Ndërsa për mallrat me karakter komercial mund të shiten.

Depot janë private, përmes procedurës së bashkëpunimit publiko-privat. Realisht të gjitha zyrtarët e Doganës janë objekte të dikujt tjetër, janë me një lloj koncensionimi, me një lloj marrëveshje ku ata ofrojnë shërbime falas për Doganën e cila të vetmen kosto që paguan është rryma elektrike dhe telefoni. Të gjitha të tjerat janë shpenzime të cilat i barte operatori i cili inkason shërbimet prej subjekteve ekonomike që operojnë. Njëjtë është edhe tek depot, d.m.th nuk paguajnë për depo të cilat janë aty ose paguajnë një shumë minimale.

Çështja e porosisë - në realitet është dashtë të hiqet ai rekomandim nga raporti i ZAP-it, sepse ka qenë pyetja rreth procedurave të bllobave të cilat përdoren për mbylljen e kamionëve.

Struktura organizative – lidhur me të gjeturën e ZAP-it është hapur konkurs i brendshëm. dhe është kryer selektimi, sot do të publikohen rezultatet se kush është zgjedhur në atë pozicion.

Akciza - të gjeturat e fundit financiare janë se në 5 muajin e parë të vitit 2011, normat e reja të akcizes kanë sjellë dikur rreth 21.5 milion euro më shumë. D.m.th ato norma e kanë efektin. Efekti është pritur vetëm 6 muajin e parë. Mirëpo, sistemi elektronik që funksionon nuk lejon ndoshta gabime të shumta ose ka shumë pak mundësi të bëhen gabime në përlogaritje të akcizës. Edhe pse auditori në dy-tri raste ka dhënë vërejtje se duhet kështu, se duhet ashtu, por ka raste kur është vështirë ndoshta të shpjegohet. P.sh Alkooli - llogaritja e akcizes nuk bëhet në sasi në litër, por bëhet në % e alkoolit të pastër dhe shpesh herë vetëm ai që është direkt në atë punë e din se ta zëmë nga deklarimet e subjektit sa ka qenë % e alkoolit të pastër. Ajo mund të krijon përshtypjen të dikush tjetër kur e sheh mos është bërë një kalkulim i gabueshëm. Sistemi i ri është një sistem elektronik i centralizuar i cili mundëson se e gjithë dogana do të jetë në një pasqyrë.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me të gjeturën “*menaxhimi jo i mirë i mallrave*” ishte i mendimit se Dogana ka befasuar të gjithë anëtarët e komisionit. Sipas përfaqësuesve të Doganës – përdoren depot që i japin falas njerëzit. Kjo a e rrit dyshimin. Pyeti: a kushton më shumë dëmtimi i mallrave sesa po të paguhej një depo e caktuar dhe a i merr përsipër të gjitha dëmtimet, sepse ai

duhet të krijon kushte për ruajtjen e mallit. Dogana duhet urgjent të hap tender apo si i ka formën e saj të procedimit për depot të cilat duhet të ruajnë mallin e konfiskuar.

Mursel Haljilji – Duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Lladrovci pyeti: nëse është fjala për marrëveshje për magazinim apo për qiramarrje? Po që se janë marrëveshje, atëherë duhet të jenë të përfunduara dhe të plotfuqishme, dhe natyrisht se do të ketë obligime edhe për njërën edhe për palën tjetër. Ku janë ato shpenzime të paraqitura në këtë raport të auditimit? E pasi që kjo është një fushë shumë e madhe ishte i mendimit se ka shumë depo të cilat janë aktivizuar. Të gjitha mallrat ruhen në hapësirat specifike për magazinim. Pastaj për mallrat të cilat prishen lehtë, duhet të ketë sistem se si të punohet me atë. Nëse hapësirat lokale nuk i përmbushim kriteret, atëherë nuk duhet të lidhen kontrata me ta për shkak se pastaj në mënyrë automatike vjen deri tek prishja e mallit dhe deri tek dëmi.

Valbona Dibra – Vlerësoi faktin që Dogana e Kosovës ka Opinion të pakualifikuar nga ZAP-i. Pyeti: pse dogana merr depo pa qira, duke e ditur se në Kosovë kontributi për shtet pa pas një përfitim është “i pakuptueshëm”? Marrja e depove pa qira le hapësirë për ndonjë favorizim të dikujt. KEK-u dhe Feronikeli janë mundësi e mirë për shkatërrimin e këtyre mallrave.

Afrim Hoti – Pyeti: cili është roli i terminalit, sidomos i atyre private me doganën dhe sa luan rol kjo në keqpërdorimin e mallrave dhe intervenimin?

Naim Huruglica - Shumica dërmuese e këtyre terminaleve janë te thëna përmes një tenderi publik, përmes një interesi publik dhe kur thuhet falas nënkupton se pjesa e shërbimeve që ata ofrojnë duhet të kenë përveç hapësirës të mjaftueshme për parkim edhe depo ku mund të deponohen mallrat. Në realitet ajo nuk është falas, sepse ai atë shërbim nuk e inkason nga dogana por e inkason nga parkimi i automjeteve transportuese të subjekteve. Depot i menaxhon Dogana, jo pala. Por Dogana nuk paguan për objekt dhe nuk merr objekt me qira, sepse kompania përmes kontratës atë dogana e kompenson përmes inkasimit për shërbimet që i ofron subjekteve. Lidhur me KEK-un dhe feronikelin- Dogana ju është drejtuar të gjithëve me kërkesë e cila është refuzuar. Sepse, as ata nuk kanë të drejtë të lejojnë shkatërrimin. Cigaret, Dogana nuk ka të drejtë t'i shes. Në momentin kur ka filluar Ligji mbi pronësinë intelektuale, në momentin që ka filluar vendosja e pullave fiskale, subjekti i cili e posedon të drejtën e firmës së emrit të cigares nuk e lejon që mallin e falsifikuar që dikush ka përdorur emrin e tij të shitet në treg. Ai mall patjetër duhet të shkatërrohet.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,

Kryesuesi - Opinioni i ZAP-it është i “pakualifikuar me theksim të çështjes”. Në vitin 2009 gjatë auditimit janë bërë 9 rekomandime në 9 fusha. Prej tyre 3 janë në adresim dhe 4 nuk janë trajtuar fare. Në faqen 8 te pasqyrat financiare shpenzimet e tërësishme të AKPM-së për vitin 2010 ishin vlerësuar me 11,147,000. Afër 45% ishin shpenzuar për subvencione. Është fjala për subvencionet e dhëna për Trepçën. Thesarin dhe buxhetin e kemi në Prishtinë. Mund të kushtëzohet dhënia e subvencioneve në vijim me llogaridhënie për subvencionet e më hershme. Monitorimi nuk ka qenë i mirë. Regjistrimi i pasurisë ka shpërputhje në mes evidencës që ka AKP-ja dhe thesari. Shpenzimet e tejkaluara sipas planit të prokurimit. Janë planifikuar 40,000 euro, ndërsa janë kontraktuar 150,000 euro. Në kontratë për furnizim me konteiner për të cilat janë planifikuar 30,000 euro janë blerë 47,000 euro. Anëtarët e komisionit nuk e kanë nënshkruar

deklaratën për betim. AKP në një furnizim ka favorizuar një operator ekonomik i cili nuk kishte ofruar të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Furnizimi me automjete është në kundërshtim me procedurat e prokurimit. Menaxhim jo i mirë në përgatitjen dhe në ekzekutimin e kontratave me shtëpitë televizive. Është bërë pa kontrata ose me kontrata që shtëpitë televizive kanë përgatitë. Pastaj malli pranohet nga personat jo përgjegjës. Shpenzimet telefonike, kanë qenë të parapara 12,000 janë shpenzuar 18,000. Të detyrat e papaguara – është ka një rritje në mënyra rapide. Nga 56,000 është 184,000. Në konkluzionet e përgjithshme mbi menaxhmentin e AKPM-së – del se Bordi i AKP-së ende nuk ka siguruar mjete funksionale të kontrollit të mënyrës që të vendos në menaxhimin efektiv dhe efikas të parasë publike. Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura.

Dino Asanaj – Raporti i auditorëve të pasqyrave financiare të vitit 2009 kishte dhënë 9 rekomandime. Nga këto rekomandime auditorët kanë konstatuar 2 prej tyre janë adresuar plotësisht, do të thotë 3 në proces të adresimit, 4 prej tyre nuk kanë arritur të adresohen. AKP e ka dorëzuar planin e zbatimit të rekomandimit të cilat do t'i zbatoj gjatë vitit 2011.

Theksimi i çështjes ka të bëjë me Trepçën. AKP-ja nuk ka arritur të ketë qasje në veri. Drejtori i pjesës veriore, ka deklaruar me shpresë se ai ende e ndien vetën të administruar nga UNMIK-u apo KTA-ja. Me 2011 për herën e parë AKP është munduar që të kushtëzoj me kontratë, mirëpo në momentin që subvencionet nuk i jepen veriut, atëherë as jugu nuk mund të marrë ato. Derisa në 2011- AKP ka kushtëzuar se asnjë subvencion nuk do të jepet nëse nuk e nënshkruajnë. Madje ata pa lejen e AKP-së kanë shpall shitjen e mbeturinave. Kanë bërë tender ndërkombëtar. Në momentin e shpalljes së shitjes AKP ka reaguar publikisht dhe duke thënë se Trepça është nën moratorium dhe vetëm oda e veçante mund ta lejojë një shitje, AKP ka alarmuar të gjitha institucionet duke shtuar këtu edhe reagimin e menjëhershëm që të ndërmerret një aksion prej EULEX-it dhe Policisë, për shkak se është jo ligjore. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i ka bërë me dije të gjitha ndërmarrjeve shoqërore, se çdo ndërmarrje shoqërore në territorin e Kosovës është pronë e Republikës së Kosovës.

Ramiz Lladrovci – Tha se shitja e mbeturinave në Trepçë në Mitrovicën e veriut është e paligjshme, por transportimi bëhet përmes pjesës jugore nëpër Mitrovicë dhe kalon kah Mali i Zi. AKP mund të kërkoj nga Qeveria e Kosovës përkatësisht MPB-ja që t'i konfiskoj ata kamionë dhe ato mbeturina. Kjo duhet ndaluar dhe nëse AKP nuk ka qasje në pjesën veriore, ajo ka qasje në pjesën jugore, konfiskimi mund të bëhet.

Muhamet Mustafa - Duhet kërkuar nga EULEX-it dhe Policia e Kosovës se pasuria e Kosovës nuk guxon të shitet pa ligj. Në qoftë se shitet pasuria përkundër vendimeve të AKP-së, atëherë do të filloj të shitet i gjithë territori. Prandaj ky është një test që nuk duhet lejuar.

Avni Jashari – Tha se plani i prokurimit i cili është bërë nga departamentet përkatëse në agjencinë e privatizimit dhe njësia e prokurimit është bërë para se të aprovohet Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2010. Me aprovimin e buxhetit të Kosovës për vitin 2010 është rritur edhe kërkesa buxhetore e cila është aprovuar nga Komisioni për buxhet dhe financa në mbledhjen e nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2009. Sipas planit të prokurimit ka qenë e paraparë me 40,000 euro të bëhet vlerësimi i dy ndërmarrjeve shoqërore. Ndërsa me rritjen e buxhetit AKP ka bërë planin për vlerësimin e gjashtë ndërmarrjeve shoqërore. Kjo ka bërë normalisht që kontrata të jetë në vlerë 150,000 euro, mirëpo ka qenë brenda buxhetit i cili është aprovuar. E njëjta situatë ka qenë edhe me kontejnerët, ngase është rritur numri i punëtorëve dhe i këshilltarëve të emëruar nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar dhe komisioni evropian. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka aprovuar rritjen e buxhetit dhe për këtë arsye është rritur numri i konteniervë të cilët janë në objektet e AKP-së dhe shfrytëzohen për nevoja të përditshme.

Sa i përket rasteve të prokurimit, AKP ka ngritur një Komision Disiplinor për të hetuar të gjithë zyrtarët e përfshirë në këtë procese.

Ekziston një gabim teknik sa i përket rastit për blerje të veturave. Është fjala për vetura me tërheqje 4x4, dhe operatori ekonomik fitues i ka plotësuar të gjithë specifikacionin teknik të paraparë nga komisioni.

Përgatitja e kontratave me shtëpitë televizive, siç mund ta shihni edhe në raport në fillim të vitit 2011 AKP ka implementuar këtë rekomandim.

Te pranimit i mallrave nga persona të paautorizuar, që nga maji i vitit 2010 me rastin e delegimit të menaxhimit nga organizatat buxhetore është caktuar zyrtari i logjistikës i cili është person përgjegjës për pranimin e të gjitha shërbimeve dhe mallrave në AKP dhe i regjistron ato në librin e protokollit, si në formë elektronike ashtu edhe në të shkruar.

Buxheti për telefoninë fikse dhe mobile ka qenë rreth 70,000 Euro kurse shpenzimet rreth 18,000 Euro. Pra buxheti për telefoninë fikse ka kursime prej 50,000 Euro. Këtu fjala është për thirrjet telefonike fiks-fiks të cilat as operatori ekonomik, pra PTK e as sistemi ynë nuk ka mundur ti gjenerojë.

Te rekrutimi i stafit, është fjala për kompletimin e kontratave në gjuhën shqipe. Për shkak të obligimeve ndaj donatorit – Komisioni Evropian dokumentacioni burimor ka qenë në gjuhën angleze. Tani kontratat janë në gjuhën shqipe, angleze dhe atë serbe.

Pasurit kapitale, është fjala për pasuri vlera neto e të cilave ka qenë 320 Euro prej numrit 4500 pasurive të ndryshme që i kemi në vlerë prej 980,000 Euro. Fjala është për 12-13 pasuri të teknologjisë informative si UPS, monitor dhe shtëpiza të vjetra të cilat kanë qenë të shpalosura por nuk kemi mundur ti gjejmë. Regjistrimi i pasurisë është në përputhje të plotë me sistemin në AKP dhe në regjistrat e Thesarit. Te shpalosja e detyrimeve të pa paguara ka ardhur si pasojë e vonësive në dorëzimin e faturave nga ana e furnitorëve.

Valbon Bytyçi - ZAP ka konstatuar se janë udhëhequr prokurime të cilat nuk janë paraparë me plan të prokurimit. Vërejtja e ZAP-it ka qenë se me plan të prokurimit janë paraparë që të vlerësohen dy ndërmarrje, ndërsa janë vlerësuar gjashtë. Në këtë rast ka pasur shmangie nga plani i prokurimit e jo nga buxheti. Ka pasur mos-përputhje në dokumentacionin e komisionit për inventarizime, është e vërtetë që kemi të bëjmë me pasuri që nuk kanë vlerë materiale, por është faktike se ka ekzistuar një mospërputhje.

Dino Asanaj -Këtu kemi të bëjmë me vlerësimin dhe auditimin e ndërmarrjeve të privatizuara me spin-off special. Në këto raste nuk mund të parashikohet me saktësi se sa ndërmarrje do të vlerësohen për vitin e ardhshëm, ngase kjo varet nga plotësimi i kushteve nga ndërmarrjet dhe AKP duhet të ekzekutoj vlerësimin. Sa i përket shpenzimeve telefonike, AKP ka tre anëtarë të bordit të cilët janë ndërkombëtarë dhe nga një herë në takime të bordit duhet komunikuar deri në tre orë me telefon.

Armend Zemaj – Tha se AKP ka trashëguar një sistem të degjeneruar nga UNMIK-u. Pyeti: si është arritur të finalizohet ky raport pa komentet e AKP? Pyeti: Sa ka arritur Bordi që së bashku me stafin e brendshëm e që njihet si shumë profesional, që kontrollin e brendshëm ta ndaj nga ajo që është trashëguar nga UNMIK-u? Është shqetësuese niveli i bashkëpunimit në mes të ZAP dhe OB, por sidomos AKP, ngase nuk ka as komente. Nga kjo lindin dilema se si do të implementoj rekomandimet AKP-ja. Është gjithnjë më bindës fakti se shqyrtimi i raporteve të ZAP-it në komision duhet të bëhet para se ato të bëhen publike.

Komisioni duhet të ketë një raport plotësues se sa janë implementuar rekomandimet. Ndërsa rekomandimi për mbledhje plenare duhet të përgatitet pasi që komisioni të shqyrtoj edhe dy raportet e tjera që kanë të bëjnë me Fondin e Privatizimit dhe Trepçën.

Murselj Haljilji - Në faqen 13, pikën 6.2 të raportit ku përmenden fondet për investime kapitale dhe subvencione thuhet “AKP transferon pothuajse çdo vit fonde për projekte kapitale si dhe subvencione tek NSH Trepça”. A është ky transfer për çdo vit apo pothuajse çdo vit? Çfarë do të thotë pothuajse? A do të thotë çdo të dytin vit apo diçka tjetër, për shkak se fjala pothuajse nuk do të thotë çdo vit. Së dyti, këto transfere janë rregulluar në bazë të Marrëveshjes për Monitorim dhe Kontroll, dhe bazuar në vetë emrin e kësaj marrëveshjeje, do të thotë se duhet të monitoruar dhe kontrolluar paratë të cilat i jepen N.SH Trepça. Pyetja është nëse ZAP-i ka mundur ta shohë atë marrëveshje dhe a do të mund komisioni të shoh atë marrëveshje, që te shoh se a ka pika të cilat përcaktojnë kontrollin e shpenzimit të parave, për shkak se marrëveshja është shumë e përcaktuar në emrin e saj dhe në përbërje të marrëveshjes përcaktohet edhe mënyra e

kontrollit. Për vitin e kaluar AKP ka transferuar 5,018,071 euro, ku diçka ka shkuar në investime e diçka në investime kapitale. Pyeti: a ka mungesë informatash për shpenzimin e këtyre shumave apo jo? A ka shkuar kjo shumë e plotë e parave në pjesën veriore të Trepçës e cila nuk mund të kontrollohet apo ka pasur edhe në pjesën jugore të Trepçës? Këto janë informata të rëndësishme për shkak se komisioni ka marrë informata vetëm se janë transferuar 5 milionë dhe nuk ka informata se cili është fati i atyre parave.

Ramiz Lladrovci – Kërkoj që AKP t'i raportoj KMFP rreth hetimeve të zhvilluara nga komisioni disiplinor për çështjet e prokurimit.

Pyeti: Te kontratat me shtëpitë televizive, a janë kushtet e njëjta për të gjithë operatorët, ngase në raport shkruan se kontratat janë bërë nga ata.

Sa i përket shpenzimeve të telefonisë, do të ishte më racionale të shfrytëzohet interneti për komunikime. Sa është e gatshme AKP që t'u ofroj operatorëve që t'i tërheqin mbeturinat nga veriu? Pse AKP ka bërë një ndarje të tillë veri dhe jug? Ishte i mendimit se Kryesuesi i Bordit duhet të raportoj (*thirret në interpelancë*) në mbledhje plenare në mënyrë që Kuvendi të mund të nxjerrë rekomandime për AKP-në dhe Qeverinë si dhe për institucionet e tjera ndërkombëtare.

Propozoi që raporti të mos procedohet në mbledhje plenare përderisa komisioni ta ketë edhe raportin për zbatimin e rekomandimeve.

Muhamet Mustafa - Kërkoj sqarim se pse nuk është arritur ende një mjedis funksional i kontrollit? A është problemi te politikat të cilat nuk janë aprovuar apo është problemi te kapacitetet e stafit? Çfarë mase do të marrë AKP në mënyrë që Komisioni të sigurohet se AKP do ta plotësoj këtë zbrazëti?

Për komisionin është esenciale që bordi i AKP-së që emërohet nga Kuvendi, ti ketë të gjithë mekanizmat dhe instrumentet që të siguroj kontrollin dhe menaxhimin financiar. Komisioni duhet të ketë një program të afatizuar të masave që të bisedojë drejtori dhe auditori se cilat janë masat, rregulloret, proceduarat që mungojnë dhe që duhet të zbatohen, në mënyrë që kur të fillojë auditimi këto çështje janë të qarta.

Alma Lama - Duke ju referuar asaj që AKP-ja ka kërkuar ndihmë nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës lidhur me mbeturinat e Trepçës, kërkoj sqarim se si kanë reaguar ata apo në çfarë mënyre kanë reaguar?

Pse është bërë blerje e veçantë për njërën nga veturat? Ndërsa në lidhje me shpenzimet e telefonisë kërkoj sqarim nëse janë shfrytëzuar për arsye private apo të punës?

Dino Asanaj – Lidhur me shpenzimet e telefonisë tha se nëse merret për bazë numri i të punësuarve i bie që një person për telefoni fikse shpenzon në muaj 4.5 Euro. Kur mungon ndonjë nga anëtarët e bordit, nuk ka mundësi tjera të komunikimit. Për ndihmën që është kërkuar, EULEX-i nuk është përgjigjur fare. Ndarja në Veri dhe Jug nuk është diçka që ka bërë AKP-ja. Rekomandimi i AKP-së ka qenë që të jenë një, e sidomos te mbeturinat që të ketë më shumë ofertues dhe të bëhet pastrimi sa më i shpejt, ngase kjo është e dëmshme edhe për ambientin. Për shkak të ligjit që ka qenë konfliktuoz, agjencia nuk ka pasur drejtor menaxhues deri në janar të këtij viti.

Shkëlzen Lluka - Në lidhje me kontrollin e brendshëm tha se AKP tërë stafin e ka trashëguar nga AKM, ngase ky ka qenë një kusht nga Komisioni Evropian. Janë në negociata me Bankën Botërore për financimin e pagave, si dhe janë në përfundim të nxjerrjes së të gjitha akteve nënligjore që rregullojnë punën e agjensionit, që të jenë në koherencë me punën e AKP-së dhe në të njëjtën kohë do të bëhet edhe ristrukturimi i agjensionit. Edhe prezenca e Zyrës Civile Ndërkombëtare do të jetë e minimizuar.

Avni Jashari - Ne me 12 prill AKP ka dorëzuar komentet auditorit të përgjithshëm të cilat ata i kanë pranuar. Komentet nuk janë përfshirë në shtojcën e raportit, kjo në pajtim me ZAP-in. Ekziston marrëveshje në mes të AKP dhe Trepçës që është nënshkruar edhe nga përfaqësuesit që menaxhojnë në Jug dhe ata në Veri, dhe është bërë në gjuhën angleze. Sipas kësaj

marrëveshje 60% e subvencioneve shkon për pjesën në Jug kurse 40% në Veri. Pjesën të cilën Veriu nuk e ka raportuar është vetëm 325, 000 Euro. Është një projekt kapital i cili është zbatuar, për të cilën edhe Veriu edhe Jugu kanë raportuar deri në çerekun e trete 2010 se si është implementuar. Raportin e fundit AKP është duke e pritur. Në marrëveshjen e fundit për 2011, pritet që të nënshkruhet nga pjesa Veriore, ku janë kushtëzuar që asnjë subvencion nuk do të jepet deri sa të dorëzohen të gjitha raportet e vitit 2010.

Ka përmirësim të kontrollit në krahasim me periudhën kur është menaxhuar nga UNMIK-u. Çdo departament ka ndarje të qartë të detyrave dhe askush nuk mundet të kryej dy funksione.

Komisioni për vlerësimin e ofertave për furnizim me vetura, ka zgjedhur operatorin që ka qenë më i përgjegjshëm ekonomikisht, dhe që i ka plotësuar të gjitha kushtet.

Me buxhetin e aprovuar është paraparë që të blihen gjashtë vetura, pesë me tërheqje 4X4, kurse vetura e gjashtë është paraparë që të blihet me xhama të errët dhe sirenë lartë që të përdoret nga drejtori menaxhues dhe kryetari i bordit dhe anëtarët e tjerë për takimi zyrtare. Vetura është e tipit të njëjtë si tjerat.

Lars Lage Oloffson - Subvencionet për Trepçën e Veriut dhe Jugut janë materiale. Bordi duhet të sigurohet që vendimet po zbatohen dhe administrata funksionon si duhet. AKP ka nevojë që bordi t'i kushtojë më shumë kohë mbikëqyrjes së kontrollit të brendshëm, se si janë dizajnuar dhe si janë implementuar. Para se Komisioni t'i drejtohet Kuvendit, do të ishte më rationale nëse do të shqyrtoj edhe raportin e ZAP-it mbi Fondin e privatizimit dhe atë të Trepçës, ngase këto të tria janë në ndërlidhura njëra me tjetrën. ZAP ka planifikuar të përcjell zbatimin e rekomandimeve në sezonin tjetër. Por, nëse komisioni kërkon më herët një raport atëherë ZAP mund ta bëjë këtë.

Valbona Dibra: E përgëzoj AKP-në për punën e bërë, ngase opinionimi është i pakualifikuar me theksim të çështjes që është një nga opinionet më të mira. Është mirë që raportet e auditorit të mos publikohen pa u bërë debat parlamentar, në mënyrë që Komisioni të mos vihet para aktit të kryer.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- 1. Raporti nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.*
- 2. Detyrohet Agjencia Kosovare e Privatizimit që në afatin sa me të shkurtër ta njoftoj komisionin me raport rreth përfundimeve të Komisioni Disiplinor të ngritur nga AKP-ja për çështjet e prokurimit.*

4. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu